

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË ARSIMIT, TRASHËGIMISË KULTURORE, TURIZMIT, DHËNIES SË TITUJVE DHE EMËRTIMEVE, MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE INTEGRIMIT EVROPIAN

Data e mbledhjes së Komisionit: 19.06.2026

Marrin pjesë:

1. Bruna Hoxha këshilltar – kryetar i komisionit
2. Suzana Rama këshilltar – zëvendëskryetar i komisionit
3. Agron Profka anëtar
4. Floreta Gjino anëtar

Z. Gupa

Pika 12 e rendit të ditës

Projektvendim: “Për miratimin e projektit ‘Rikonstruksioni i shkollës “Halit Grëmi” dhe palestër, Mbrostar Ura, Fier”, propozuar nga Kryetari i Bashkisë Fier.

Drejtuesi i komisionit prezantoi projektvendimin dhe relacionin shoqërues.

Nga dokumentacioni i sjellë pranë sekretarisë së këshillit bashkiak komisioni u informua mbi gjendjen ekzistuese të objektit, duke evidentuar problematikat e lagështirës, amortizimin e ambienteve të brendshme, gjendjen e tualeteve, sistemin e dritareve dhe nevojën për ndërtimin e një palestere sportive.

Pyetje nga këshilltarët:

- Cili është afati i realizimit të projektit?
- Cili është burimi i financimit?
- Si do të organizohet procesi mësimor gjatë punimeve?

Përfaqësuesit e administratës sqaruan se projekti synon përmirësimin e kushteve të procesit mësimor dhe sportiv, se fondi i parashikuar është sipas projektit të hartuar dhe se procedurat do të ndiqen sipas legjislacionit në fuqi.

Këshilltarët vlerësojnë rëndësinë e ndërtimit të palestrës si një investim në funksion të nxënësve dhe komunitetit. Hidhen në votë propozimet për amendim të projektvendimit:

Përgatitet raporti i komisionit për t’iu paraqitur Këshillit Bashkiak në seancë.

Lexohet raporti nga Kryetari i Komisionit.

Votohet raporti:

PRO 4

KUNDËR -

ABSTENIM -

Raporti MIRATOHET

Komisioni vendosi t’i rekomandojë Këshillit Bashkiak miratimin e projekt-vendimit “Për miratimin e projektit ‘Rikonstruksioni i shkollës “Halit Grëmi” dhe palestër, Mbrostar Ura, Fier”.

Mbyllet mbledhja e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bruna Hoxha

Sekretari i Komisionit

Yllka Sheshi

Sipas procesverbalit të mbledhjes ku nuk ishte për arsye personale le jani dakort me raportin e komisionit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I PËRHERSHËM PËR ARSIMIN, TRASHËGIMINË KULTURORE, TURIZMIN, DHËNIEN E
FUQIVE DHE EMËRTIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE INTEGRIMIN EVROPIAN

RAPORT VENDIMMARRJE

datë 19.06.2026

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Fier

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit "Për miratimin e projektit 'Rikonstruksioni i shkollës "Halit Grëmi" dhe palestër, Mbrostar Ura, Fier", relacionit dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Fier.

ANALIZA LIGJORE

Komisioni shqyrtoi projektvendimin dhe dokumentacionin shoqërues, të mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si dhe legjislacionin në fuqi për planifikimin, investimet publike dhe administrimin e pasurisë publike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se projekti është kompetencë e Bashkisë Fier dhe lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e funksioneve të saj në fushën e arsimit parauniversitar dhe infrastrukturës arsimore.

SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT

Shkolla 9-vjeçare "Halit Grëmi", në njësinë administrative Mbrostar Ura, paraqet problematika të amortizimit të godinës, lagështirë në ambientet e brendshme, dëmtime të shtresave të dysHEMEVE, amortizim të dyerve dhe dritareve, si dhe degradim të ambienteve sanitare.

Nga dokumentacioni teknik rezulton nevoja për ndërhyrje rikonstruktive me qëllim përmirësimin e kushteve të procesit mësimor, rritjen e sigurisë së nxënësve dhe përmbushjen e standardeve bashkëkohore të infrastrukturës arsimore.

Projekti parashikon gjithashtu ndërtimin e një palestere sportive, e cila do të shërbejë për zhvillimin e veprimtarive sportive dhe edukative të nxënësve.

DREJTORIA / SEKTORI PËRGJEGJËS

Për zbatimin dhe monitorimin e projektit përgjegjëse janë:

- Drejtoria e Hartimit të Projekteve dhe Kontrollit të Punëve Publike;
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit;
- Drejtoria e Arsimit pranë Bashkisë Fier.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi i realizimit të projektit do të kryhet nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Fier në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Raportimi mbi ecurinë e investimit do të bëhet periodikisht pranë Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak sipas fazave të realizimit të projektit.

IMPAKTI SOCIAL / GRUPET QË PREKEN

Projekti ka ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv mbi:

- nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Halit Grëmi";
- stafin pedagogjik dhe administrativ të shkollës;
- prindërit dhe komunitetin e zonës së Mbrostar Urës.

Investimi pritet të përmirësojë ndjeshëm kushtet e edukimit, sigurinë dhe aksesin në aktivitete sportive për fëmijët dhe të rinjtë e zonës.

... PËRHERSHËM PËR ARSIMIN, TRASHËGIMINË KULTURORE, TURIZMIN, DHËNIEN E
... DHE EMËRTIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE INTEGRIMIN EVROPIAN,
... më datë 19.06.2026, pasi shqyrtoi projektvendimin, relacionin dhe dokumentacionin teknik
... për projektin "Rikonstruksioni i shkollës "Halit Grëmi" dhe palestër, Mbrostar Ura, Fier",
VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak Fier:
b) MIRATIMIN e projektaktit.
2. Të vlerësojë projektin si një investim me interes publik të lartë në funksion të përmirësimit të infrastrukturës arsimore dhe sportive.
3. Të rekomandojë monitorimin periodik të zbatimit të projektit dhe raportimin e ecures së tij pranë Këshillit Bashkiak.

Kryetar i Komisionit
Bruna Hoxha
(emri, mbiemri, firma)



Datë: 19..06.2026

Sekretar i Komisionit
Yllka Sheshi
(emri, mbiemri, firma)

